

V E N D I M
Nr. 230, datë 22.7.1991

PER KRIJIMIN E KOMISIONEVE TE TOKAVE

Me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Krijimin e Komisionit Qeveritar të Tokës dhe të komisioneve të tokës në rrethe dhe fshat, me funksion të përkohshëm.

1. 8. ⁹I. Komisioni Qeveritar i Tokës

Komisioni Qeveritar i Tokës është organ kolegjal, pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Përbërja e tij përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Komisioni ka këto detyra dhe të drejta:

- Drejton, organizon, bashkërendon dhe kontrollon punën në Ministri, institucione të tjera qendrore, në këshillat e rretheve e në fshatra për zbatimin e ligjit për tokën.

- Ndjek zbatimin e ligjëshmërisë për rindarjen dhe kalimin e tokave në pronësi a në përdorim të subjekteve të ndryshme; merr në shqyrtim dhe vendos për zgjidhjen e çështjeve që ngrejne komisionet e rretheve për tokën; zgjidh mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet rretheve për kufijtë e tokës; kërkon hartimin e dokumentacionit përkatës për punën e bërë nga komisioni i rrethit dhe ai i fshatit.

*Kompetencat e Komisionit Qeveritar të Tokës ndërmjet dy mbledhjeve ushtrohen nga kryesia e tij, e cila përbëhet nga Kryetari, dy Zv/kryetarët, sekretari dhe juristi. Vendimet e marra nga kryesia ndërmjet dy mbledhjeve të Komisionit raportohen në mbledhjen e ardhshme të tij dhe marrin formën e prerë pas miratimit

- *Thërret në mbledhjet e tij drejtuesit e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit dhe të komisionit të tokës në rreth për të raportuar për gjendjen dhe masat e marra për zbatimin e ligjit të tokës e të akteve të tjera nënligjore që lidhen me të.

- Në rrethet ku ndarja e tokës po zvarritet, ka shkelje të përsëritura të kriterëve që kanë krijuar mosmarrëveshje për ndarjen e tokës dhe komisioni i tokës në rreth nuk zbaton kompetencat sipas këtij vendimi, Komisioni Qeveritar i Tokës, pas shqyrtimit të veprimtarisë së komisionit të tokës në këto rrethe, i propozon Këshillit të Ministrave marrjen e masave disiplinore deri në shkarkimin e drejtuesve të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit dhe të komisioneve të tokës në rrethe.

Kur dikasteret dhe institucionet qendrore zvarritin, ose u shmangen çështjeve dhe detyrave të ngarkuara për zbatimin e ligjit të tokës, përfaqësuesit e tyre thirren në Komisionin Qeveritar të Tokës, ku merren vendimet përkatëse për t'u dhënë zgjidhje problemeve të veçanta.

3. 2. 7 II. Komisioni i tokës në rreth.

*Komisioni i tokës në rreth kryesohet nga kryetari i Këshillit të Rrethit dhe ka këto të drejta dhe detyra:

1. Zgjidh mosmarrëveshjet që kanë lindur në ndarjen e kooperativës, duke patur parasysh:

a) sipërfaqen dhe kufijtë e tokës bujqësore;
b) tokat e reja që janë hapur qysh nga krijimi i kooperativës së bashkuar.

2. Zgjidh mosmarrëveshjet që kanë lindur ndërmjet individëve dhe komisionit të tokës në fshat.

3. Zgjidh problemet që kanë dalë kur është shpërbërë tërësisht kooperativa dhe i ka mbetur pak tokë.

4. Shqyrton e vendos për materialet që i paraqiten nga komisionet e fshatit së bashku me propozimet e veçanta të tyre.

5. Bën propozime për shqyrtim në Komisionin Qeveritar të Tokës.

6. Krijon grupe specialistësh dhe i autorizon ato për të marrë pjesë në komisionin e tokës në fshat dhe për të hartuar dokumentacionin e plotë kadastral për tokën.

*7. Kur vërehet që specialistët topografë e agronomë dhe anëtarë të tjerë të komisioneve të fshatrave neglizhojnë në kryerjen e detyrës dhe kanë lejuar padrejtësi në ndarjen e tokës, komisioni i tokës në rreth i shkarkon ata dhe i zëvendëson me specialistë të tjerë.

**8. Në raste të veçanta, kur komisioni i fshatit nuk funksionon normalisht, komisioni i tokës në rreth ka të drejtë ta shkarkojë atë dhe në vend të tij të emërojë një komision të ri, i cili drejtohet nga kryeplaku i fshatit.

Në përbërjen e komisionit të ri të fshatit emërohen specialistët më të aftë topografë e agronomë të shërbimit agronomik, juristë dhe përfaqësues të organeve të rendit e të pushtetit në fshat.

Komisioni i tokës në rreth ka të drejtë të vendosë kthimin tërësisht ose pjesërisht të shpërblimit të marrë prej anëtarëve të komisionit të fshatrave që shkarkohen. Vendimi i komisionit në rreth është titull ekzekutiv.

Komisioni i tokës në rreth ka të drejtë t'i propozojë organeve përkatëse masa disiplinore deri në largim nga detyra të drejtuesve të organeve të rendit, hetuesisë, prokurorisë dhe gjykatës për moszbatimin e detyrave që lidhen me ligjin për tokën.

4.10.11 **II/a. Komisioni i tokës në komunë.**

Komisioni i tokës në komunë emërohet nga këshilli i rrethit, kryesohet nga kryetari i komunës dhe ka këto detyra:

a) Ndjek zbatimin e ligjit "Për tokën" në fshatrat që janë në juridiksion të tij.

b) Shqyrtton mosmarrëveshjet që kanë lindur ndërmjet fshatrave brenda juridiksionit të komunës.

c) Shqyrtton mosmarrëveshjet që kanë lindur ndërmjet komisionit të tokës së fshatit dhe individëve.

ç) I relatton komisionit të rrethit mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet komisioneve të fshatrave për ndarjen e kufijve të fshatrave në juridiksion të tij.

d) Thërret komisionet e fshatrave për zbatimin e detyrave për ndarjen e tokës.

e) Pranë çdo komune të depozitohet një kopje e të gjithë dokumentacionit të ndarjes së tokës. Kryetari i komunës, me cilësinë e kryetarit të komisionit të ndarjes së tokës, përgjigjet për plotësimin dhe shpërndarjen e dokumentacionit të tokës.

e/1. Në të gjitha rastet kur në juridiksionin e bashkisë ka edhe fshatra, atëherë ngrihet dhe funksionon komisioni i tokave të bashkisë, i cili kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe ka të gjitha detyrat dhe atributet që parashikohen për komisionin e tokave në komunë.

Edhe në këtë rast këshilli i rrethit siguron mjetet financiare për ndarjen e tokës, si dhe administron e kontrollon këto fonde.

f) Komisioni i tokës në komunë kontrollon dhe përgjigjet për administrimin e fondeve për ndarjen e tokës. Kryepleqtë e fshatrave dhe personat e tjerë të autorizuar prej tyre të paguhën për aq ditë sa do të punojnë për plotësimin e dokumentacionit.

g) Në rastet kur gjykohet e vlerësohet për shpërblim pune të komisioneve a specialistëve, komisioni i ndarjes së tokës të komunës i propozon kryetarit të komisionit të tokës në rreth, i cili vendos për masën e shpërblimit dhe personat deri në dy paga mujore.

Për komisionet e rretheve, me propozimin e grupit të Komisionit Qeveritar të Tokës, vendos Kryetari i Komisionit Qeveritar të Tokës.

5.6.12 **III. Komisioni i tokës në fshat.**

Komisioni i tokës në fshat përbëhet nga kryeplaku i fshatit dhe dy specialistë (topograf dhe agronom), që do t'i rekomandojë komisioni i tokës në rreth. Kryetari i komisionit emërohet nga kryeplaku i fshatit. Vendimet e komisionit janë të formës së prerë.

Komisioni i tokës në fshat është unikal dhe ekzekuton ndarjen e tokës, pavarësisht nga subjekti që i përkiste më parë

Komisioni ka këto të drejta dhe detyra:

1. Bën verifikimin e numrit dhe përbërjen e familjeve të anëtarëve të kooperativave bujqësore, si dhe të familjeve të tjera që banojnë në fshat, mbi bazën e gjendjes civile dhe përcakton sipërfaqen që i takon çdo familjeje.

2. Bën ndarjen e tokës dhe korrigjimet e nevojshme për mosmarrëveshjet e lindura duke pasur parasysh që dhënia e tokës të bëhet:

a) sipas kushteve territoriale të tokës, pa marrë parasysh kufijtë e vjetër;

b) sipas mundësisë për ta dhënë atë në një vend dhe sa më pranë shtëpisë.

3. Përcakton madhësinë e tokës bujqësore dhe vendin ku do t'i jepet toka familjeve që dëshirojnë të shkëputen nga kooperativa bujqësore e të dalin subjekt më vete. Ndarja e tokës bëhet mbi bazën e numrit të frymëve të çdo familjeje, brenda kooperativës ku ajo bën pjesë

*4. Problemet dhe mosmarrëveshjet që i lindin t'i paraqesë në komisionin e tokës në rreth nëpërmjet komisionit të tokës në komunë.

5. Komisioni pasi përcakton, në bashkëpunim me fshatarët, vendin dhe sipërfaqen e tokës të secilit, përpilon në dy kopje aktmarrjen e tokës nga çdo familje, me firmë të kryetarit të komisionit e të specialistit të autorizuar nga komisioni i rrethit, si dhe të kryefamiliarit që merr tokën.

Komisioni i fshatit harton raportin për punën e bërë për dhënien e tokës e për problemet e tjera të pazgjidhura. Ky raport firmoset nga të gjithë pjesëtarët e komisionit. bashkë me të gjithë aktet e marrjes së tokës. Kopje të këtyre dokumenteve i dorëzohen komisionit të tokës në rreth.

6. Në mbështetje të materialit të komisionit të fshatit, miratuar edhe nga ai i rrethit, zyra e kadastrës harton grafikun e punimeve dhe ngarkon specialistët e autorizuar për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm kadastral.

Vendimi nr. 198, datë 24.6.1991 shfuqizohet.

Ky vendim lryn në fuqi menjëherë

**KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE
ALEKSANDER MEKSI**

Ndryshime në vendimin nr.230, datë 23.7.1991

Akt i ndryshuar:

Akt që ndryshon:

¹ Vendim 230 1991 Kap I	Paragraf i shtuar	Vendim 173	1992	Pika 1
⁸ Vendim 230 1991 Kap I/p1	Ndryshim në pikë	Vendim 270	1993	Pika 1
⁹ Vendim 230 1991 Kap I	Paragraf i shtuar	Vendim 448	1993	Pika 1
³ Vendim 230 1991 Kap II	Paragraf i shtuar	Vendim 111	1993	Pika 1
² Vendim 230 1991 Kap II/7-8	Pikë e shtuar	Vendim 173	1992	Pika 2
⁷ Vendim 230 1991 Kap II/8	Ndryshim në pikë	Vendim 112	1993	Pika 1
⁴ Vendim 230 1991 Kap IIa	Kre i shtuar	Vendim 111	1993	Pika 2
¹⁰ Vendim 230 1991 Kap IIa/e-g	Pikë e shtuar	Vendim 175	1995	Pika 1
¹¹ Vendim 230 1991 Kap IIa/e1	Pikë e shtuar	Vendim 331	1995	Pika 1
⁵ Vendim 230 1991 Kap III/p1	Ndryshim në pikë	Vendim 111	1993	Pika 3
⁶ Vendim 230 1991 Kap III/4	Ndryshim në pikë	Vendim 111	1993	Pika 4
¹² Vendim 230 1991 Kap III/p2	Paragraf i shtuar	Vendim 331	1995	Pika 2